Ndikimi i

Gjuhës së Urrejtjes si Mjet Politik

në

Rininë e Kosovës

Korrik 2016

USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

Ndikimi i Gjuhës së Urrejtjes si Mjet Politik në Rininë e Kosovës

Të drejtat e autorit© 2016 Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore.
Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Deklaratë e lejes: Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet në asnjë formë ose në asnjë mënyrë, elektronike ose mekanike, përfshirë fotokopjimin, regjistrimin apo me ndonjë sistem për rruajtje dhe nxjerrje të informatave pa lejen me shkrim të IFES-it.

Në kërkesat për leje duhet të përfshihen informatat e mëposhtme:

- Përshkrimi i materialit për të cilën dëshirohet leja për kopjim.
- Qëllimin për të cilin do të përdoret materiali i kopjuar dhe mënyra në të cilën do të përdoret.
- Emri juaj, titulli, emri i kompanisë apo organizatës, numri i telefonit, numri i faksit, e-mail adresa dhe adresa e postës

Ju lutem dërgoni të gjitha kërkesat për leje t'i dërgoni në:

International Foundation for Electoral Systems
2011 Crystal Drive, Floor 10
Arlington, VA 22202
E-mail: editor@ifes.org
Fax: 202-350-6701

Ky raport është mundësuar nga përkrahja bujare e popullit Amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Opinionet e shprehura në këtë raport janë të autorit(ëve) dhe jo domosdoshmërisht i pasqyrojnë pikëpamjet e USAID-it apo Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Përmbajtja

A. Përmbledhje Ekzekutive 1

B. Hyrje 1

C. Metodologjia 2

D. Pikëpamjet e shprehura në fokus grupe 3

1. Pikëpamjet e pjesëmarrësve lidhur me kuptimin e gjuhës së urrejtjes 4
2. Pikëpamjet e pjesëmarrësve se ku përdoret gjuha e urrejtjes 5
3. Pikëpamjet e pjesëmarrësve mbi arsyet e përdorimit të gjuhës urrejtëse 6
4. Reagimet e pjesëmarrësve ndaj gjuhës së urrejtjes 6
5. Pikëpamjet e pjesëmarrësve mbi gjuhën e urrejtjes dhe dhunën 7

E. Përgjigjet e pjesëmarrësve ndaj deklarimeve fiktive 8

1. Skenari një – politik 9
2. Skenari dy – politik 11
3. Skenari tre – fetar 13
4. Skenari katër – etnia 15

F. Përfundim 16

Shtojca I: Legjislacioni i Kosovës mbi lirinë e shprehjes dhe gjuhën e urrejtjes 18

Shtojca II: Definicionet dhe ndalimi i gjuhës së urrejtes, nga burime ndërkombëtare 19

Shtojca III: Shkalla e notimit e përdorur për deklaratat e skenarëve fiktiv 20

A. Përmbledhje Ekzekutive

Ky raport hulumton ndikimin e mundshëm të gjuhës së urrejtjes në politikë mbi rininë e Kosovës. Raporti paraqet pikëpamjet e të rinjve se si ata e kuptojnë gjuhën e urrejtjes, ku përdoret gjuha e urrejtjes dhe nga kush, dhe si ndikon tek ndjenjat dhe sjelljet e të rinjve. Informatat e paraqitura në këtë raport janë marrë nga gjashtë fokus grupe të mbajtura në rajone të ndryshme të Kosovës me të rinjë të moshës 15 deri 29 vjeçare.

Në përgjithësi, pjesëmarrësit në fokus grupe e perceptonin gjuhën e urrejtjes si shprehje apo gjuhë që përdoret për të ofenduar, turpëruar, apo diskriminuar një individ apo grup, kryesisht mbi baza se ata janë të tjerë në kombësi, etni apo përcaktim politik. Pjesëmarrësit gjithashtu bënin lidhje në mes gjuhës së urrejtjes dhe sjelljeve ofenduese, etiketimeve, xhelozisë dhe me konfliktet nga e kaluara.

Gjetje e përbashkët nga të gjitha gjashtë fokus grupet ishte se gjuha e urrejtjes përdoret më së shumti nga politikanët. Në përgjithësi, pjesëmarrësit pohuan se gjuha e urrejtjes është shumë më e pranishme aktualisht, dhe se janë të ekspozuar ndaj kësaj gjuhe çdo ditë në lajme, debate televizive, protesta dhe rrjete sociale.

Në përgjithësi, pjesëmarrësit ishin të mendimit se liderët politik përfitojnë personalisht nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes ndaj kundërshtarëve të tyre politik apo ndaj grupeve të tjera. Ekzistonin mendime të ndryshme lidhur me arsyen përse politikanët përdorin gjuhën e urrejtjes: për t'i denigruar kundërshtarët politik, për të fituar mbështetje më të madhe nga votuesit të cilët ndajnë mendimet e tyre, për të përfituar fuqi politike duke turpëruar të tjerët, për të tërhequr vëmendjen tek gabimet e kundërshtarëve politik, për të margjinalizuar grupet për arsye se ata janë ndryshe, për të krijuar ndarje në mes grupeve etnike, dhe për ta larguar vëmendjen nga problemet e vërteta shoqërore.

Në përgjithësi, pjesëmarrësit besonin se gjuha e urrejtjes ka ndikim negativ mbi shoqërinë dhe sidomos mbi të rinjtë dhe personat që jetojnë në kushte të varfra ekonomike. Kryesisht, pjesëmarrësit dënuan përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe kryesisht nuk mbështesin politikanët të cilët përdorin gjuhë të urrejtjes. Në përgjithësi, përdorimi i dhunës nuk u arsyetua pa marrë parasysh rrethanat, edhe pse disa pjesëmarrës theksuan se dhuna mund të arsyetohet në disa rrethana të veçanta.

B. Hyrje

Liria e shprehjes është një ndër të drejtat më themelore të garantuara nga instrumentet ligjore ndërkombëtare dhe vendore. Neni 19 (2) i Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP) thekson se "Secili duhet të ketë të drejtën e lirisë së shprehjes [...]". Ngjashëm me këtë, Neni 40 (1) i Kushtetutës së Kosovës thekson që "Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendim edhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush. [...]"

Liria e shprehjes i nënshtrohet kufizimeve të caktuara. Neni 19 (3) i KNDCP parasheh që liria e shprehjes i nënshtrohet kufizimeve "të cilat duhet të përcaktohen shprehimisht me ligj dhe të jenë të domosdoshme (a) Për respektimin e të drejtave ose të reputacionit të të tjerëve; (b) Për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, të rendit publik, të shëndetit ose të moralit publik." Kufizime të lirisë së shprehjes gjithashtu janë paraparë tek Neni 40 (2) i Kushtetutës së Kosovës, ku parashihet se "Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare".

Njëra ndër arsyet për kufizimin e lirisë së shprehjes është parandalimi i përdorimit të gjuhës së urrejtjes. Ka një mungesë të hulumtimeve mbi çështjen e gjuhës së urrejtjes në Kosovë dhe nuk ka informata të qarta se si të rinjtë e perceptojnë gjuhën e urrejtjes dhe deri në çfarë mase janë të ekspozuar ndaj kësaj gjuhe. Po ashtu, nuk ka vijë të qartë ndarëse në mes të gjuhës fyese dhe ofenduese, si dhe shprehjeve që mund të konsiderohen si gjuhë e urrejtjes. Diskutimet në fokus grupe sugjerojnë se nëse një formë e shprehjes nxit apo nuk nxit urrejtje, varet shumë nga konteksti në të cilën përdoret dhe perceptimet që të rinjtë kanë ndaj saj.

Ky raport shqyrton ndikimin e gjuhës së urrejtjes si mjet politik mbi të rinjtë e Kosovës. Raporti paraqet pikëpamjet e të rinjve se si ata e kuptojnë gjuhën e urrejtjes, ku përdoret dhe nga kush, dhe si ndikon tek ndjenjat dhe sjelljet e të rinjve. Gjetjet e paraqitura në pjesën e analizës janë të bazuara në hulumtimin kualitativ të realizuar përmes gjashtë fokus grupeve në rajone të ndryshme të Kosovës, me të rinj të moshave nga 15 deri në 29 vjeçare. Raporti gjithashtu shqyrton perceptimet e pjesëmarrësve lidhur me gjuhën e urrejtjes duke vlerësuar se si janë përgjigjur ndaj katër deklaratave fiktive, për të cilat është kërkuar t'i vlerësojnë gjatë fokus grupeve. Në shtojca, raporti i referohet dispozitave të ndërlidhura me lirinë e shprehjes dhe gjuhës së urrejtjes brenda kornizës ligjore të Kosovës, definicionit dhe ndalimit të gjuhës së urrejtjes nga instrumente të ndryshme ndërkombëtare, si dhe shkallën e vlerësimit të përdorur për vlerësimin e reagimeve ndaj deklaratave fiktive gjatë fokus grupeve.

Ky raport është përgatitur nga studentë[1] bachelor të angazhuar në punë praktike hulumtuese, si pjesë e programit të IFES në Kosovë të financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), 'Rritja e Përfshirjes dhe Zvogëlimi i Dhunës në Proceset Elektorale', nën udhëheqjen e stafit të IFES në Kosovë. Ky raport është njeri nga tri raportet mbi hulumtimet e çështjeve të pjesëmarrjes së rinisë në Kosovë të përgatitura nga IFES në vitin 2016. Dy raportet tjera paraqesin gjetjet mbi rolin e rinisë në subjektet politike, dhe pjesëmarrjen e votuesve të rinjë në zgjedhje.

C. Metodologjia

Ky raport e shqyrton ndikimin e gjuhës së urrejtjes politike mbi rininë e Kosovës. Gjetjet e paraqitura në këtë raport bazohen në diskutimet e gjashtë fokus grupeve të zhvilluara në rajone të ndryshme të Kosovës

[1] Rrita Rugova (Rochester Institute of Technology Kosovë), Endrit Dibrani dhe Rudinë Fetahaj (Fakulteti i Shkencave Politike në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"). Kishte gjithashtu kontribute nga Hana Bacaj dhe Fjoralba Krapi (Rochester Institute of Technology Kosovë) gjatë fazave fillestare të hulumtimit.

me të rinjtë të moshave 15 deri 29 vjeçare. Kjo grup moshë përdoret në definicionin e rinisë nga USAID. Fokus grupet janë përbërë nga 8 deri në 12 pjesëmarrës nga rajone dhe vendbanime të ndryshme. Tabela në vijim paraqet informata më të hollësishme mbi përbërjen e fokus grupeve. Njëra nga gjashtë fokus grupet është zhvilluar me minoritetin Serb në Mitrovicën Veriore.

<table>
<tr><td colspan="2">Rajoni</td><td>Prishtinë</td><td>Prizren</td><td>Pejë</td><td>Gjilan</td><td>Mitrovicë</td><td>Mitrovicë Veriore</td></tr>
<tr><td colspan="2">Vendbanimi</td><td>Urban</td><td>Urban</td><td>Rural</td><td>Urban</td><td>Rural</td><td>Urban</td></tr>
<tr><td colspan="2">Lokacioni</td><td>Prishtinë</td><td>Malishevë</td><td>Novosellë</td><td>Gjilan</td><td>Rezallë</td><td>Mitrovicë Veriore</td></tr>
<tr><td rowspan="4">Grup Moshat</td><td>15-17</td><td></td><td rowspan="2">1</td><td rowspan="2">1</td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>18-21</td><td rowspan="2">1</td><td rowspan="3">1</td><td rowspan="2">1</td><td></td></tr>
<tr><td>22-25</td><td></td><td></td><td rowspan="2">1</td></tr>
<tr><td>26-29</td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
</table>

Pjesëmarrësit e fokus grupeve janë përzgjedhur përmes metodës së rastësishme “snow-ball”. Gjatë procesit të përzgjedhjes së pjesëmarrësve, është marrë në konsideratë barazia gjinore dhe rekrutimi i individëve me prapavijë të ndryshme socio-ekonomike. Në fokus grupe u diskutua lidhur me perceptimet e rinisë mbi gjuhën e urrejtjes, nivelin e ekspozimit të tyre ndaj gjuhës së urrejtjes, fushat në të cilat ata mendojnë se përdoret dhe nga kush, dhe si kjo ndikon tek sjellja e të rinjve.

Pjesëmarrësit në fokus grupe gjithashtu plotësuan një pyetësor të shkurtër ku janë përgjigjur ndaj katër skenarëve fiktiv me shkrim, që përshkruanin (1) një figurë politike të profilit të lartë që paraqitej në një transmetim publik; (2) një lider të partisë politike duke iu drejtuar një turme të madhe në një protestë publike; (3) një udhëheqës fetar duke bërë deklaratë në një radio program; dhe (4) një person duke shprehur mendime në një debat publik në mes liderëve të etnive të ndryshme. Është kërkuar nga pjesëmarrësit të vlerësojnë sesi janë ndier lidhur me gjuhën e përdorur në secilën nga këta skenar, dhe se çfarë ndikimi do të kishin në veprimet e tyre. Të dhënat janë paraqitur në pjesën E të këtij raporti.

Vetëm një numër i kufizuar i fokus grupeve ka qenë i mundur për t’u realizuar brenda burimeve në dispozicion për këtë hulumtim. Ekipet hulumtuese dëshirojnë që t’i falënderojnë pjesëmarrësit të cilët kanë marrë pjesë në fokus grupe dhe që kanë kontribuar në gjetjet e paraqitura në këtë raport. Pikëpamjet e pjesëmarrësve kanë qenë mjaftë të ndryshme, mirëpo janë studiuar, grupuar, dhe paraqitur me kujdes në pjesën e gjetjeve të këtij raporti.

D. Pikëpamjet e shprehura në fokus grupe

Kjo pjesë e raportit është e ndarë në pesë pjesë dhe paraqet mendimet e pjesëmarrësve lidhur me: (1) kuptimin e gjuhës së urrejtjes; (2) fushat në të cilat përdoret gjuha e urrejtjes; (3) arsyet për përdorimin e gjuhë së urrejtjes; (4) mënyrat se si kjo gjuhë ndikon tek rinia; (5) lidhjet e mundshme në mes të gjuhës së urrejtjes dhe dhunës.

1. Pikëpamjet e pjesëmarrësve lidhur me kuptimin e gjuhës së urrejtjes

Për shumicën e pjesëmarrësve, gjuha e urrejtjes nënkuptonte shprehje apo gjuhë që përdoret për të ofenduar, turpëruar, apo diskriminuar një individ apo grup bazuar në dallimet e tyre të kombësisë, etnisë apo përkatësisë politike. Pjesëmarrësit i vunë theks të veçantë këtyre dallimeve, por dallimet racore, fetare, dhe të orientimit seksual ishin cekur gjithashtu si bazë e mundshme për shfrytëzimin e gjuhës së urrejtjes. Disa nga përgjigjet e pjesëmarrësve përfshijnë: `qëndrimin fyes ndaj kombësisë, racës dhe etnisë`, `diskriminimin dhe paragjykimin`, `ndarjen etnike`, `diskriminimin ndaj një personi, grupi apo kombi`, `denigrimin e ndonjë subjekti tjetër`, dhe `manipulimin politik`.

Një përgjigje e shpeshtë në mesin e pjesëmarrësve ishte ndërlidhja e gjuhës së urrejtjes me emrat etiketues, apo etiketimet që përdoren për të përshkruar individë apo grupe. Shpeshherë, pjesëmarrësit i veçuan fjalët si `magjup` apo `shkije` për t'i identifikuar fjalët që mund të nxisin urrejtje. Pjesëmarrësit gjithashtu theksuan se gjuha e urrejtjes mund të manifestohej atëherë kur njerëzit thirren sipas detyrës që kryejnë dhe jo me emër, dhe disa nga shembujt përfshinin etiketimet si `kamarier` apo `pastruese`.

Tek të gjitha fokus grupet, pjesëmarrësit ishin të mendimit se gjuha e urrejtjes përmbanë shprehje që zakonisht përdoren nga liderët politik ndaj kundërshtarëve të tyre. Në përgjithësi, pjesëmarrësit argumentuan se liderët politik përdorin gjuhën e urrejtjes me qëllim të arritjes së qëllimeve personale. Pjesëmarrësit tjerë definuan gjuhën e urrejtjes nga aspekti i dhunës dhe konflikteve nga e kaluara, duke u përgjigjur me fraza si: `dhuna dhe frika`, `shkakton luftë, ndanë dhe vranë`, `konflikt [...] e kaluara`, `diçka që shkakton konflikt në mes njerëzve dhe grupeve`.

Disa pjesëmarrës e lidhën gjuhën e urrejtjes me xhelozinë, apo theksuan se xhelozia është arsyeja përse individët apo grupet përdorin gjuhën e urrejtjes. Disa fraza dhe fjalë të përdorura si shembuj nga pjesëmarrësit përfshinin: `xhelozia është në mesin e faktorëve për urrejtje`, `faktori [i gjuhës së urrejtjes] është xhelozia – për shkak të frikës se të tjerët janë në pozitë më të mirë`. Tregimi i `Borbardhës` ishte cekur shpeshherë nga pjesëmarrësit.

Disa pjesëmarrës mendonin se ka dallim në mes të gjuhës së urrejtjes dhe fyerjes. Nga pikëpamja e tyre, gjuha e urrejtjes është më sistematike dhe ka ndikim më të madh. Për ta dëshmuar këtë, një student i drejtësisë në Prishtinë theksoi se "Përdorimi i gjuhës fyese nuk mund të barazohet me gjuhën e urrejtjes, besojë që gjuha e urrejtjes është diçka sistematike që është e drejtuar kah një person".

Një pjesëmarrëse femër vizatoi një skeç (djathtë) të një plumbi të shkrepur nga një gojë dhe të drejtuar drejt një personi, si një mënyrë e përshkrimit se çka i bie ndërmend kur e dëgjon për herë të pare fjalën `gjuhë e urrejtjes`.

Në tërësi, pjesëmarrësit meshkuj dhe femra kishin këndvështrime të ngjashme lidhur me të kuptuarit e gjuhës së urrejtjes. Një këndvështrim i rrallë lidhur me kuptimin e gjuhës së urrejtjes është paraqitur nga

dy pjesëmarrëse femra në fokus grupet e Prishtinës dhe të Gjilanit, ku që të dyja theksuan se gjuha e urrejtjes përdorët rëndom për të shprehur xhelozinë që femrat e ndiejnë ndaj dukjeve të femrave tjera.

2. Pikëpamjet e pjesëmarrësve se ku përdoret gjuha e urrejtjes

Gjetje e përbashkët nga të gjitha fokus grupet është se gjuha e urrejtjes zakonisht përdoret nga politikanët. Pjesëmarrësit në Gjilan u pajtuan në përgjithësi se politikanët zakonisht përdorin gjuhë të urrejtjes ndaj njerëzve të cilët kanë mendime të tjera nga ta. Në Mitrovicën Veriore, pjesëmarrësit ishin të mendimit që gjuha e urrejtjes përdoret nga politikanët për t'i arritur interesat personale, apo për të krijuar ndarje në mes grupeve etnike. Në Rezallë, pjesëmarrësit në përgjithësi u pajtuan se gjuha e urrejtjes përdoret nga politikanët si mjet për të denigruar kundërshtarët e tyre politik dhe për ta paraqitur vetën superior.

> *"... kur njeriu më i lartë i shtetit ka ofenduar tërë popullin, kjo është një urrejtje, ose si ti thuash më ndryshe, kur e ka ulë një popullë të tërë"*
> - Student i Filozofisë nga Rezalla

Në tërësi, pjesëmarrësit theksuan se dëgjojnë gjuhë të urrejtjes shumë shpesh në transmetimet e lajmeve dhe debatet televizive, dhe se kjo ishte më e theksuar gjatë krizës së fundit politike në Kosovë. Një pjesëmarrës mashkull nga Malisheva theksoi se në të kaluarën nuk ishte ballafaquar aq shumë me gjuhë të urrejtjes, mirëpo tani këtë e dëgjon gati çdo ditë në televizion. Gjithashtu në Malishevë, një pjesëmarrëse femër shprehu brengën e saj lidhur me nivelin e ndikimit të gjuhës se urrejtjes tek fëmijët të cilët janë të ekspozuar ndaj saj. Ishin disa pjesëmarrës të cilët theksuan se nuk i shikonin programet e lajmeve në televizion mu për arsyen se dëgjojnë gjuhë të urrejtjes gjatë transmetimeve të lajmeve. Në Malishevë, një pjesëmarrës mashkull theksoi se çdoherë kur dëshiron të dëgjoj gjuhë të urrejtjes, ai thjeshtë shikon debatet politike në televizion. Pjesëmarrësit gjithashtu pohuan të kenë dëgjuar gjuhë të urrejtjes gjatë protestave të partive opozitare. Një pikëpamje tjetër e përbashkët ishte se gjuha e urrejtjes përdoret në rrjetet sociale çdo ditë, në profilet e miqve të pjesëmarrësve dhe tek politikanët që ata i përcjellin.

> *"televizioni në shtëpinë time është pothuajse gjatë tërë kohës i ndezun edhe pa dasht po i dëgjon ato fjalë edhe kur rrin me një rreth edhe i dëgjon këto fjalë ndoshta pa vetëdije i mëson edhe vet edhe i perdorë"*
> - Pjesëmarrës mashkull në Gjilan

Kishte gjithashtu pjesëmarrës të cilët mendonin se gjuha e urrejtjes përdoret në muzikë. Në Malishevë, një pjesëmarrëse femër pohoi të ketë hasur në gjuhë të urrejtjes tek tekstet e këngëve. Një pjesëmarrës mashkull në Gjilan theksoi se një këngëtar i "rap" muzikës përdorë gjuhë të urrejtjes në muzikën e tij, "e shohë që shokët e mi që e dëgjojnë atë flasin me gjuhën e tij kur flasin për Serbët". Pjesëmarrësit tjerë u pajtuan se qëllimi prapa muzikës është të dërgohen mesazhe fyese, mirëpo nuk mendonin që përdorimi i gjuhës së urrejtjes në muzikë medoemos do të shpinte tek dhuna.

Ishte edhe një pikëpamje tjetër e theksuar nga pjesëmarrësit se gjuha e urrejtjes përdoret nga njerëzit të cilët kanë frikë, të cilët motivohen nga hakmarrja, të cilët kanë vetëbesim të dobët, të cilët kanë morale të ulëta, të cilët xhelozojnë njëri tjetrin, të cilët nuk kanë shkathtësi tjera për të arritur qëllimet, apo të

cilët kanë ndikim tek popullata. Pikëpamjet e disa pjesëmarrësve pasqyronin një shkallë të tensionit apo armiqësisë së bazuar në gjini, qe ishte ndryshe prej pikëpamjes te zakonshme për gjuhë të urrejtjes në kornizën politike.

3. Pikëpamjet e pjesëmarrësve mbi arsyet e përdorimit të gjuhës urrejtëse

Pjesëmarrësit theksuan se liderët politik kanë arsye personale për përdorimin e gjuhës urrejtës ndaj kundërshtarëve të tyre politik dhe ndaj grupeve tjera. Kishte disa arsye shpesh të cekura nga të gjitha fokus grupet lidhur me atë se përse politikanët përdorin gjuhën e urrejtjes: për të denigruar kundërshtarët politik, për të fituar më shumë përkrahje nga votuesit të cilët mbështesin pikëpamjet e tyre, për të fituar fuqi politike duke turpëruar të tjerët, për të tërhequr vëmendjen tek keq-përdorimet e kundërshtarëve politik, për të margjinalizuar grupet e caktuara bazuar në dallimet e tyre, për të krijuar ndasi në mes grupeve etnike, dhe për ta larguar vëmendjen nga problemet e vërteta shoqërore. Pjesëmarrësit nga Mitrovica Veriore vendosën theks të veçantë tek qëllimi i liderëve politik për të shkaktuar ndarje në mes grupeve etnike, posaçërisht për të larguar vëmendjen nga problemet shoqërore apo duke i dedikuar shkaqet e problemeve shoqërore tek grupet e tjera të shoqërisë.

Një pjesëmarrëse femër në Gjilan ishte e mendimit që politikanët janë të motivuar për ta përdorur gjuhën e urrejtjes për arsye se kjo kërkohet nga opinioni publik, duke thënë se `njerëzit kanë nevojë të ushqehen me urrejtje`. Kjo pikëpamje pasqyrohej edhe tek pjesëmarrësit në Mitrovicën Veriore, të cilët ishin të mendimit se politikanët përdorin gjuhën e urrejtjes sepse njerëzit dëshirojnë të dëgjojnë diskurs të tillë.

Pjesëmarrësit në të gjitha fokus grupet gjithashtu cekën disa arsye të tjera përse njerëzit në përgjithësi përdorin gjuhën e urrejtjes. Disa nga këto përfshijnë: për t'i bërë të tjerët të ndihen inferior, për tu dukur superior ndaj tjerëve, për t'i denigruar personalitetet e të tjerëve, për ta fuqizuar një pozitë apo status më të mirë. Një pjesëmarrëse femër pohoi se gjuha e urrejtjes ndonjëherë përdoret në mes femrave për të fyer një person për shkak të dukjes.

4. Reagimet e pjesëmarrësve ndaj gjuhës së urrejtjes

Në përgjithësi, pjesëmarrësit pohuan se nuk janë drejtpërdrejt të ndikuar nga gjuha e urrejtjes. Në të gjitha katër grupet, pjesëmarrësit në përgjithësi shprehën shkathtësi për të ekzaminuar në mënyrë kritike deklaratat e bëra nga liderët politik, fetar dhe të tjerë. Pjesëmarrësit tjerë u shprehën të lodhur nga politikanët të cilët shpesh e përdorin gjuhën urrejtëse, dhe pohuan se kanë më tepër gjasa t'i injorojnë deklaratat e politikanëve. Kishte edhe disa pjesëmarrës që nuk treguan aspak interesim në politikë dhe pohuan se nuk janë të ndikuar nga gjuha urrejtëse e politikës.

Pjesëmarrësit megjithatë theksuan se ndiheshin të 'mërzitur', `me ndjenja të këqija' dhe `të irrituar` kur ata i ekspozohen gjuhës së urrejtjes. Kjo ishte më e zakonshme në mesin e pjesëmarrëseve femra. Pjesëmarrësit në të gjitha katër grupet kryesisht dënuan gjuhën e urrejtjes, dhe ishin të mendimit se ata që përdorin gjuhen e urrejtjes kanë ndikim negativ tek shoqëria.

Pjesëmarrësit theksuan se kishin më tepër gjasa të ndërprerin mbështetjen e tyre për politikanët të cilët përdorin gjuhë urrejtëse, dhe për subjektet politike që ata përfaqësojnë. Në Novosellë, pjesëmarrësit deklaruan se opinionet e tyre ndaj personit që ka përdorur gjuhë urrejtëse janë prishur, ndërsa nuk ka ndryshime të opinionit për ata kundër të cilëve gjuha urrejtëse është përdorur. Pikëpamja e pjesëmarrësve në Novosellë ishte se një mënyrë e sanksionimit të atyre që përdorin gjuhë të urrejtjes është që mos t'i të votojnë prapë për ta. Në Gjilan, pjesëmarrësit pohuan se gjuha urrejtëse ka më shumë gjasa të dëmtojë politikanët, sepse qytetarët do të distancohen nga ata. Një mendim i ngjashëm ndahej nga pjesëmarrësit e Mitrovicës Veriore. Në Prishtinë, pjesëmarrësit pohuan se po të reagonin ndaj gjuhës së urrejtjes në ndonjë mënyrë, do të ishte përmes mjeteve paqësore, sikur protestat paqësore.

> *"Njëri nga ta [shokët] flet me fjalë banale kur diskutojmë për politikë ... dhe ai fliste me fjalë që kishte dëgjuar nga politikanët e që nënkupton se kanë nxitur urrejtje tek ai"*
> - Pjesëmarrës mashkull në Gjilan

Pjesëmarrësit pranuan faktin se gjuha urrejtëse ka më shumë gjasa të ndikonte tek rinia dhe personat që jetojnë në kushte të varfëra ekonomike. Në Mitrovicën Veriore, pjesëmarrësit ishin të mendimit se gjuha e urrejtjes ka më shumë gjasa të ndikojë tek ata me kushte të pamjaftueshme të jetesës. Në Gjilan, Prishtinë dhe Rezallë pjesëmarrësit mendonin se gjuha urrejtëse gjatë protestave ka ndikuar tek rinia në drejtim të aktiviteteve të dhunshme, si hedhja e gurëve në drejtim të ndërtesave qeveritare.

Disa pjesëmarrës theksuan se për shkak se kanë dëgjuar gjuhë të urrejtjes shumë shpesh në media gjatë viteve të fundit, ata kanë zhvilluar një tolerancë të lartë për të dhe ndihen indiferent ndaj saj. Në Mitrovicën Veriore pjesëmarrësit besojnë se ekziston një tolerancë e përgjithshme ndaj dhunës, dhe se do të ishte e dëmshme për ta të intervenonin në një incident të dhunshëm, si dhe që nuk kanë besim tek autoritetet e drejtësisë që të merren me sjelljet e dhunshme.

> *"Në të kaluarën e kam dashur politikën shumë, i shikoja debatet politike dhe dukej se po i bënin gjërat si duhet dhe me pëlqente puna e tyre, tani ata përdorin protestat, nxënës të shkollave të mesme për t'i arritur qëllimet e tyre, dhe tani i them vetes nëse kjo është politikë - atëherë nuk më duhet asgjë"*
> - Pjesëmarrëse femër në Malishevë

Një këndvështrim i ndryshëm ishte paraqitur nga të anketuarat femra. Ato në përgjithësi besojnë se gjuha e urrejtjes ndikon tek rinia negativisht, dhe se promovon urrejtje në mes tyre. Dy femra të anketuara në Malishevë të cilat kishin ambicie të bëheshin politikane, kishin vendosur që mos ta ndjekin këtë qëllim pasi që vlerësuan situatën e tanishme politike, duke shprehur zhgënjim dhe hidhërim ndaj politikës. Një pjesëmarrëse tjetër nga Prishtina theksoi se çdoherë kur ajo e gjen vetën në një diskutim politik, ajo kërkon që të ndryshohet tema.

5. Pikëpamjet e pjesëmarrësve mbi gjuhën e urrejtjes dhe dhunën

Diskutimi rreth dhunës ishte pothuajse i pashmangshëm gjatë diskutimit për gjuhën e urrejtjes. Në përgjithësi, pjesëmarrësit veçuan një marrëdhënie në mes përdorimit të gjuhës së urrejtjes në protesta dhe përfshirjen e rinisë në aktivitete të dhunshme, posaçërisht në protestat e fundit. Në Prishtinë, pjesëmarrësit theksuan se njerëzit përdorin dhunën gjatë protestave për shkak të gjuhës së urrejtjes. Në

Rezallë, disa pjesëmarrës ishin të mendimit se partitë politike manipulojnë me rininë dhe i nxisin të bëhen të dhunshëm në takime publike.

Pjesëmarrësit në Rezallë ishin të mendimit se kurdo që njerëzit mblidhen për të protestuar, rritet rreziku i kalimit nga gjuha urrejtëse në dhunë. Pjesëmarrësit në Novosellë mendonin që personat e moshës nga 18 deri 35 vjeçare janë më të prirë për të manifestuar sjellje të dhunshme në protesta.

> *"Sa më të mëdha turmat, aq më ndikuese do jenë fjalimet e politikanëve"*
> - Pjesëmarrës mashkull në Rezallë

Në Mitrovicën Veriore, pjesëmarrësit ishin të mendimit se rivaliteti në mes tifozëve të klubeve sportive shkakton vepra të dhunës në mesin e rinisë. Sipas pjesëmarrësve, partitë politike keqpërdorin këto grupe për të organizuar takime publike dhe protesta, dhe për të ushtruar frikë dhe kërcënim ndaj mbështetësve të partive tjera, në mënyrë që t'i arrijnë synimet e tyre politike dhe ekonomike.

Pjesëmarrësit në përgjithësi nuk e arsyetuan dhunën, por kishte disa përjashtime. Një pjesëmarrës mashkull në Novosellë pohoi se "[gjërat] nuk mund të ndreqen pa dhunë" ndërsa një tjetër i të njëjtit grup theksoi se edhe nëse vendi vuan nga varfëria dhe korrupsioni i nivelit më të lartë, dhuna nuk është e arsyeshme gjatë protestave. Në Prishtinë, një pjesëmarrës mashkull ishte i mendimit që votimi është mënyra alternative për fillimin e ndryshimeve.

Një perspektivë tjetër ishte ndarë nga disa pjesëmarrës në Rezallë, të cilët mendonin se dhuna në protesta është e arsyetueshme në raste të veçanta. Ata shpjeguan se popullata është e irrituar nga mungesa e progresit, dhe se kur dalin në rrugë, ata e shprehin mllefin e tyre duke hedhur gurë drejt ndërtesave qeveritare. Në Prishtinë, një mashkull theksoi se ky hidhërim mund të shpie tek dhuna kur disa lider politik shprehin mendimin e tyre në debate publike, dhe se protestat paqësore nuk kanë efekt dhe se pa dhunë nuk do të ketë ndryshime.

> *"Nuk mund t'i thuash një personi që nuk arrin ta ushqej vetën dhe familjen që mos të protestojë apo të mos bëj dhunë…"*
> - Pjesëmarrës mashkull në Rezallë

E. Përgjigjet e pjesëmarrësve ndaj deklarimeve fiktive

Katër skenar të shkruar janë shpërndarë tek pjesëmarrësit gjatë fokus grupeve, duke paraqitur deklarata fiktive të: (1) një figure politike e profilit të lartë që paraqitej në një transmetim publik; (2) një lideri të partisë politike duke iu drejtuar një turme të madhe në një protestë publike; (3) një predikuesi fetar duke bërë deklaratë në një radio program; dhe (4) një personi duke shprehur mendime në një debat publik në mes liderëve të etnive të ndryshme.

Pas leximit të skenarëve, është kërkuar nga pjesëmarrësit të plotësojnë dy kategori të pyetjeve me qëllim të vlerësimit të mënyrës sesi janë ndierë lidhur me gjuhën e përdorur në secilin prej këtyre skenarëve, dhe se çfarë ndikimi do kishin në veprimet e tyre. Rezultatet nga përgjigjet e pjesëmarrësve në secilën prej skenarëve janë paraqitur në vijim.

1. Skenari një – politik

1. Në një program të popullarizuar televiziv të një shërbimi publik transmetues, në një diskutim në mes të partive kryesore në vend, një person i lartë politik (personi që është duke e bërë deklaratën) përdor gjuhë të ulët kundër kundërshtarit të vet (personi kundër të cilit bëhet deklarata):

"Këta sahanlëpirësa të regjimit të tanishëm janë duke e plaçkitur popullin tonë. Në vend që të punojnë për interesat e qytetarëve, ata punojnë vetëm për interesat e tyre individuale. Ky regjim po e bllokon zhvillimin e vendit. Nuk kemi me ndejt duarkryq. Do të dalim në rrugë dhe do t'i marrim institucionet me zor. Do t'i qërojmë hesapet me të gjithë ata që nuk janë me ne. Programi ynë politik është më i miri dhe vetëm ne dijmë ta udhëheqim këtë vend. Ne nuk jemi magjup që t'i nënshtrohemi gjithkujt. Të gjithë të tjerët janë të paedukuar dhe të poshtër. Vetëm ne mund ta nxjerrim këtë vend prej krizës që e ka kap."

Debati vazhdoni derisa politikanët akuzojnë ashpër njëri tjetrin.

Më shumë se dy të tretat e pjesëmarrësve (69%) besojnë se një deklaratë e tillë nxitë veprime të dhunshme, dhe më shumë se gjysma (53%) ndihen jo rehat duke lexuar këtë skenar. Megjithatë, gati një e treta (31%) e pjesëmarrësve nuk ndihen të zemëruar ndaj personit që bënte deklaratën, në krahasim me 41 përqind të cilët e ndjejnë një gjë të tillë. Ndërsa vetëm 15 përqind e pjesëmarrësve u pajtuan se promovohet demokracia duke përdorur deklarata të tilla (15%), vetëm dhjetë përqind ndjenë simpati ndaj personit që bënte deklaratën, dhe gati një e katërta (24%) u ndjen të zemëruar ndaj personave kundër të cilëve bëhej deklarata (Figura 1).

Në diskutimin lidhur me skenarin një, një pjesëmarrës mashkull në Malishevë tha "nuk mund ta quash dikë sahanlëpirës" - një mendim i ngjashëm u nda edhe nga dy pjesëmarrëse femra në Rezallë. Një pjesëmarrëse femër në Malishevë ishte e mendimit se deklarata përmbante elemente diskriminuese, posaçërisht kur ceket fjala 'magjup'. Një student i shkencave politike në Prishtinë ishte i mendimit që i tërë skenari përmbante gjuhë urrejtëse.

Figura 1: Si u ndien pjesëmarrësit pasi që lexuan skenarin e parë (72 pjesëmarrës)



Kur u pyetën se si do të vepronin pasi që kanë lexuar këtë deklaratë, një proporcion i njëjtë i pjesëmarrësve do ta kritikonin verbalisht personin të cilit po i raportoheshin pikëpamjet, sikur edhe i atyre që nuk do ta kritikonin (34% për secilin reagim). Shumica e pjesëmarrësve (81%) nuk do të votonin në zgjedhje për dikë që bën deklarata të tilla (Figura 2). Një mashkull, student i ekonomisë nga Rezalla, theksoi se "varet sepse ka disa njerëz që e meritojnë që gjuha e urrejtjes të përdoret ndaj tyre, dhe përtej kësaj, ata janë të aftë t'i pranojnë këto fjalë nëse i meritojnë". Shumë pak nga pjesëmarrësit than se do të vepronin me dhunë si rezultat i deklaratës, kundër personit në shënjestër të deklaratës (8%), apo kundër personit që bën deklaratën (4%). Në anën tjetër, 59 përqind do të protestonin paqësisht kundër tij.

Figure 2: Si do vepronin pjesëmarrësit pasi që lexuan skenarin e parë (72 pjesëmarrës)



2. Skenari dy – politik

2. Në një protestë publike, ku janë mbledhur shumë persona, në protestë të ftuar nga një nga partitë kryesore opozitare në vend, kryetari i partisë (personi që është duke e bërë deklaratën) i drejtohet masës me zë thumbues dhe tronditës:

"Ne duhet të jemi të vendosur ta zbresim këtë regjim prej pushtetit (personi/grupi kundër të cilit bëhet deklarata). Dialogu politik nuk është duke sjell rezultate pozitive. Ata na kanë dëmtuar së tepërmi, e kanë dëmtuar pasurinë tonë kombëtare dhe i kanë dëmtuar qytetarët e këtij vendi. Ata janë duke u sjell të papërgjegjshëm, duke na shkaktuar dëme afat-gjate. Është turp që ne duket t'i nënshtrohemi këtyre pallavrave. Gjithë çka dëgjojmë janë fjalë boshe, me premtime të rrejshme dhe gënjeshtra pa fund."

Protestuesit e thërrasin me vrull emrin e kryesuesit. Tensioni i krijuar në masë zbutet përderisa kryesuesi e kryen prezantimin e vet. Masa shpërndahet në mënyrë të qetë.

Në përgjithësi, pjesëmarrësit kishin më shumë ndjenja neutrale lidhur me këtë skenar sesa me skenarin një. Një pjesëmarrës mashkull në Gjilan theksoi se njerëzit në Kosovë janë mësuar me deklarata të tilla si kjo e paraqitur në skenarin dy. Pothuajse një e treta (27%) e pjesëmarrësve besonin se demokracia promovohet duke përdorur gjuhë të tillë. Më shumë se gjysma (53%) e pjesëmarrësve nuk ndjenin simpati për personin/grupin në shënjestër të deklaratës, ndërsa gati gjysma e të anketuarave (49%) mendonin se një deklaratë e tillë nxit akte të dhunshme (Figura 3). Në Prishtinë dhe Mitrovicë Veriore, disa pjesëmarrës nuk ishin të bindur se ky skenar përmbante gjuhë te urrejtjes. Një student i shkencave politike në Prishtinë deklaroi se ky skenar "nuk e sulmonte askënd drejtpërdrejt". Megjithatë, disa pjesëmarrës në Novosellë paraqitën theksuan se ky skenar përmbante më shumë gjuhë të urrejtjes sesa skenarët tjerë, duke argumentuar se në protestë një incident i vogël mund të rezultojë në daljen e situatës jashtë kontrollit.

Figura 3: Si u ndien pjesëmarrësit pasi që lexuan skenarin e dytë (71 pjesëmarrës)



Sikur tek skenari një, vetëm disa besojnë se do të nxiteshin për dhunë nga kjo deklaratë, qoftë kundër personit në shënjestër të deklaratës (3%) apo kundër personit që bën deklaratën (6%), edhe pse pothuajse gjysma besonte se deklarata të tilla nxisin veprime të dhunshme. Pothuajse një e treta (32%) e pjesëmarrësve besonin se do të protestonin të qetë kundër personit në shënjestër të deklaratës, dhe më shumë se një e katërta (26%) do ta bënin një gjë të tillë kundër personit i cili bën deklaratën. Deklarata duket të mos ketë pas ndikim pozitiv mbi qëllimet për të votuar, ku 13 përqind theksuan se do të votonin për personin që bënte deklaratën, dhe 8 përqind për personin në shënjestër të deklaratës. Megjithatë, deklarata kishte ndikim të fuqishëm negativ mbi qëllimet për të votuar. Më shumë se gjysma e të anketuarave (53%) besonin se nuk do votonin për personin që bën deklarata të tilla, ndërsa 60 përqind do kishin pak gjasa të votonin për personin(at) në shënjestër të deklaratës (Figura 4).

Figure 4: Si do vepronin pjesëmarrësit pasi që lexuan skenarin e dytë (71 pjesëmarrës)



3. Skenari tre – fetar

3. Në një radion stacion, një predikues/udhëheqës fetar i njohur (personi që është duke e bërë deklaratën) është mysafir i një prezantuesi të popullarizuar. Pasi që pranojnë një telefonatë nga një telefonues anonim (personi/grupi kundër të cilit bëhet deklarata), telefonues i cili nuk e ndan mendimin e njëjtë sikurse mysafiri, predikuesi thekson:

"Nëse një person nuk beson në zot dhe nuk i nënshtrohet, ai nuk mund të punoj për të mirën e këtij vendi. Sepse mosbindja tregon nënshtrimin ndaj dreqit. Sipas udhëzimeve dhe dëshirës së zotit, ne do të mbledhim të gjitha forcat dhe do ta luftojmë të keqen. Dhe, kushdo që nuk na bashkëngjitet, në do t'i tregojmë se janë duke shkuar në drejtim të gabuar.

Shumë telefonues tjetër e cekin nevojën që të bllokohen thirrësit që nuk e përkrahin qëndrimin e predikuesit dhe dënojnë personat që e vejnë në dyshim autoritetin e udhëheqësve fetar.

Përderisa më shumë se një e treta (36%) e pjesëmarrësve u ndien rehat duke lexuar këtë deklaratë, pothuajse dy të tretat (60%) besuan se një deklaratë e tillë nxit veprime të dhunshme. Pothuajse gjysma (49%) e pjesëmarrësve u ndien të zemëruar ndaj personit që bën deklaratën, dhe shumica (82%) besuan se demokracia nuk promovohet me përdorimin e gjuhës së tillë. Katërmbëdhjetë përqind simpatizuan personin që bënte deklaratën, ndërsa mbi një e katërta u ndien të zemëruar ndaj personit në shënjestër të deklaratave politike tek skenarët një dhe dy (Figura 5). Një pjesëmarrës mashkull nga Gjilani theksoi se varet se kush i dëgjon deklaratat si kjo, sepse niveli i ndikimit mund të ndryshojë nga një person tek personi tjetër.

Figure 5: Si u ndien pjesëmarrësit pasi që lexuan skenarin e tretë (35 pjesëmarrës)



Duke vazhduar me trendin e dy skenarëve të parë, pak nga të anketuarit besonin që do të nxiteshin për dhunë nga kjo deklaratë, si në rastin e personit në shënjestër të deklaratës (3%) apo në rastin e personit që bënte deklaratën (3%), edhe pse 60 përqind besonin se deklarata të tilla nxisin veprime të dhunshme. Më shumë se një e treta (35%) e pjesëmarrësve besojnë se do ta kritikonin në formë verbale personin të bënte deklaratën, ndërsa 40% do të kishin gjasa të protestonin në mënyrë paqësore kundër këtij personi. Sikur edhe tek dy skenarët politik, kjo deklaratë kishte ndikim pozitiv mbi qëllimet e votimit tek shumë pak pjesëmarrës, mirëpo kishte ndikim të gjerë negativ mbi qëllimet e votimit në lidhje me personin që bënte deklaratën si dhe atë në shënjestër të deklaratës (Figura 6).

Figura 6: Si do vepronin pjesëmarrësit si rezultat i leximit të skenarit të tretë (35 pjesëmarrës)



4. Skenari katër – etnia

4. Në një debat te nxehtë televiziv në mes të përfaqësuesve të partive politike në vend, ku marrin pjesë persona të grupeve të ndryshme etnike, një nga personat (personi që është duke e bërë deklaratën) që merr pjesë në debat u thotë pjesëmarrësve tjerë (personave/grupit kundër të cilëve bëhet deklarata) të debatit:

"Një komb me identitet gjysmak e ka të vështirë ta merr veten dhe ta ndërtoj të ardhmen. Ne kemi përgjegjësi për këtë vend. Si një vend me vlera dhe trashëgimi të përbashkët, duhet të jemi fanatik në mbrojtjen e tyre. Si vendas, nuk lejojmë që ardhacakët ta njollosin kulturën tonë. Këta të tjerët [duke bërë me gisht kah personi i grupit tjetër etnik] nuk e kanë vendin këtu, në këtë territor që na takon neve. Për më tepër, gjaku i paraardhësve tanë është gjak i pastër, gjak fisnik. Nëse është e nevojshme edhe do të luftojmë në emër të identitetit tonë kombëtar; të gjithë që nuk janë si ne nuk duhet ta kenë vendin këtu."

Pjesëmarrësit në debat nga grupi etnik pakicë fishkëllehen nga audienca/spektatorët dhe ata janë të obligoar ta lëshojnë debatin. Ata njihen në rrugë dhe janë evidentuar disa sulme fizike ndaj tyre pak pas këtij debati.

Pothuajse gjysma (47%) e pjesëmarrësve ndiheshin jo rehat gjatë leximit të skenarit, ndërsa më shumë se një e pesta (23%) simpatizuan personin(at) në shënjestër të deklaratës. Përderisa më shumë se gjysma (55%) e pjesëmarrësve ndihen të zemëruar ndaj personit që bën deklaratën, rreth një e pesta (21%) simpatizuan personin që bën deklaratën. Dy të tretat e pjesëmarrësve u pajtuan që deklarata të tilla nxisin veprime të dhunshme (Figura 7). Në Prishtinë, pothuajse të gjithë pjesëmarrësit u pajtuan se ky skenar i bazuar në etninë kishte më shumë gjuhë urrejtjes sesa skenarët e tjerë të gjuhës politike dhe fetare - ku një pjesëmarrës mashkull shtoi se "kjo është një deklaratë tipike e gjuhës së urrejtjes". Ngjashëm, një pjesëmarrës në Mitrovicën Veriore theksoi se nga të gjitha skenarët "ky është më i keqi [...] dhe është drejtpërdrejt i ndërlidhur kundër dikujt dhe është një fjalim që nuk shtjellon fare fakte".

Figure 7: Si u ndien pjesëmarrësit pasi që lexuan skenarin e katërt (38 pjesëmarrës)



Kjo deklaratë e bazuar në etni duket të ketë pas ndikim më të lartë të shënuar tek pjesëmarrësit lidhur me reagimin në mënyrë të dhunshme kundër atyre në shënjestër të deklaratës: 11 përqind do kishin gjasa të bënin diçka të tillë, në krahasim me 3 përqind tek skenarët dy (politik) dhe tre (fetar), si dhe 8 përqind tek skenari një (politik). Trembëdhjetë përqind do të kishin gjasa të votonin për personin që bënte deklaratën, që është barabartë me proporcionin e pjesëmarrësve tek skenari një dhe më i lartë sesa tek skenarët dy dhe tre (të dyja ishin 3%). Kishte shumë gjasa të mos ndikonte deklarata mbi qëllimet e votimit në lidhje me personin(at) ndaj të cilit(ve) bëhej deklarata. Kishte një proporcion të konsiderueshëm (40%) të pjesëmarrësve që besonin se do të protestonin në mënyrë paqësore kundër personit të cilit po i raportohej deklarata (Figura 8).

Figura 8: Si do vepronin pjesëmarrësit si rezultat i leximit të skenarit të katërt (38 pjesëmarrës)



F. Përfundim

Disa konkluzione të gjera janë nxjerrë duke u bazuar në gjetjet e paraqitura në këtë raport, duke veçuar se gjetjet janë të bazuara në një numër të vogël të fokus grupeve me rininë, që dhanë një sërë pikëpamjesh të rinisë, por mund të mos jenë përfaqësuese të pikëpamjeve të gjithë rinisë në Kosovë.

- **Nuk ekziston një definicion apo kuptim i vetëm i gjuhë së urrejtjes në mesin e rinisë Kosovare:** Përderisa shumica e pjesëmarrësve të fokus grupeve e perceptonin gjuhën e urrejtjes nga aspekti i shprehjeve apo gjuhës së përdorur për të ofenduar, turpëruar apo diskriminuar të tjerët duke u bazuar në dallimin e tyre kombëtar, etnik apo përkatësisë politike, të tjerët e ndërlidhen gjuhën urrejtëse me gjuhën e fyerjes, etiketimet, xhelozinë, dhe konfliktet nga e kaluara;
- **Ka një nivel të lartë të ekspozimit të rinisë Kosovare ndaj gjuhës së urrejtes:** Një numër i konsiderueshëm i pjesëmarrësve në fokus grupe pohuan se janë të ekspozuar ndaj gjuhës së urrejtjes në baza ditore tek transmetimet e lajmeve, debatet televizive, protestat dhe mediat sociale;

- **Përdoruesit më të shpeshtë të gjuhës së urrejtjes janë politikanët:** Në diskutimet e tyre, të anketuarit e fokus grupeve shpeshherë veçuan politikanët, të cilët nga vështirmi i tyre përdorin gjuhë urrejtëse, dhe ishin në përgjithësi të mendimit se politikanët përdorin gjuhën e urrejtjes për tu paraqitur më superior tek të tjerët dhe të përfitojnë fuqi politike në llogari të kundërshtarëve të tyre politik;
- **Ata që përdorin gjuhën e urrejtjes kanë më tepër gjasa t'i bindin të rinjtë mos të votojnë për ta:** Pjesëmarrësit e fokus grupeve theksuan se në përgjithësi ndjeheshin të mërzitur dhe të irrituar kur dëgjonin gjuhë të urrejtjes. Ata gjithashtu dënuan përdorimin e gjuhës së tillë. Kur reaguan ndaj skenarëve, për tre nga katër skenarët, më shumë se tri të katërtat e pjesëmarrësve theksuan se nuk kishin gjasa të votonin për personin që bënte deklaratën, ndërsa për deklaratën e tjetër mbi gjysma nuk do të bënte një gjë të tillë. Kjo jap sugjerim se në nivel të madh përdorimi i gjuhës së urrejtjes apo gjuhës fyese mund të reduktojë mbështetjen politike nga ana e rinisë. Megjithatë, kishte akoma, për disa skenarë, një numër të konsiderueshëm të pjesëmarrësve (deri në 13%) të cilët ishin ndikuar pozitivisht për të votuar nga deklarata - e që përfaqësonte një bllok të konsiderueshëm votuesish;
- **Ka perceptim të gjerë se ekziston një marrëdhënie në mes gjuhës së urrejtjes dhe dhunës:** Pjesëmarrësit e fokus grupeve ishin në përgjithësi të mendimit se gjuha e urrejtjes mund të ndikonte tek rinia dhe personat që jetojnë në kushte të varfëra ekonomike për tu kyçur në veprime të dhunshme, dhe i veçuan disa raste kur partitë politike kanë nxitur rininë për të bërë një gjë të tillë në protesta dhe në takime të tjera publike. Kjo është një fushë që do të përfitonte nga hulumtime shtesë;
- **Ka një ndarje në mes të pikëpamjeve të deklaruara të të rinjve dhe reagimeve specifike:** Përderisa pikëpamja e pjesëmarrësve në të gjitha fokus grupet ishte se gjuha e urrejtjes nuk kishte ndikim tek ta personalisht, fakti që gati një e katërta e pjesëmarrësve ndjeheshin të zemëruar ndaj personit(ave) në shënjestrës së deklaratave tek tri skenarë, sugjeron se gjuha e urrejtjes mund të ketë në të vërtet ndikim mbi një proporcion të konsiderueshëm të të rinjve, edhe në mesin e atyre që nuk e pranojnë këtë ndikim. Kjo ndasi në mes asaj sesi të rinjtë i perceptojnë reagimet e tyre ndaj gjuhës së urrejtjes dhe reagimet e tyre të vërteta ndaj deklaratave që mund të konsiderohen si gjuhë e urrejtjes, do të mund të përfitonte gjithashtu nga hulumtimet shtesë.

Shtojca I: Legjislacioni i Kosovës mbi lirinë e shprehjes dhe gjuhën e urrejtjes

Kushtetuta e Republikës së Kosovës	**Neni 40 Liria e shprehjes** 2. Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare. **Neni 42 Liria e Mediave** 2. Censura është e ndaluar. Askush nuk mund të pengojë shpërndarjen e informacionit ose të ideve nëpërmjet mediave, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare. **Neni 44 Liria e Asociimit** 3. Organizatat ose aktivitetet që kanë për qëllim cenimin e rendit kushtetues, shkeljen e lirive dhe të drejtave të njeriut, ose nxitjen e urrejtjes racore, kombëtare, etnike a fetare, mund të ndalohen me vendim gjyqësor të gjykatës kompetente.
Ligji për zgjedhjet e përgjithshme (03/L-073)	**Neni 33 Veprimet e Ndaluara të Subjekteve** Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërës si në vijim: […] l) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë; *[Kjo shkelje gjobitet me 10,000 deri ne 30,000 Euro sipas rregullores 01/2012 të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa]* […] **Neni 34 Frikësimi dhe Dhuna Gjatë Procesit Zgjedhor** 34.1 Përdorimi ose kërcënimi me përdorim të dhunës së çfarëdo lloji nga subjekti politik, anëtarët, mbështetësit ose kandidatët e tyre, ndalohet rreptësishtë. 34.2 Asnjë subjekt politik ose kandidatët nuk inkurajojnë, mbështesin ose miratojnë dhunën, kërcënimet me dhunë ose kanosje, gjatë procesit zgjedhor. Secili subjekt politik i informon anëtarët dhe mbështetësit e tij për nevojën për të shmangur një sjellje të tillë. 34.3 Fushata zgjedhore organizohet në atë mënyrë që një atmosferë e pëlqyeshme dhe paqësore të mbizotërojë gjatë fushatës zgjedhore.
Kodi Penal i Republikës së Kosovës (04/L-082)	**Neni 147 Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik** 1. Kushdo që nxit ose përhap publikisht urrejtje, përçarje ose mos durim midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike apo grupe tjera të tilla që jetojnë në Republikës e Kosovë, në mënyrën e cila mund të prishë rendin publik, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet. […]

Shtojca II: Definicionet dhe ndalimi i gjuhës së urrejtes, nga burime ndërkombëtare

"Termi 'gjuhë e urrejtjes` nënkupton si i tillë përfshirjen e të gjitha formave të shprehjeve që shpërndajnë, nxisin, promovojnë apo arsyetojnë urrejtjen racore, ksenofobinë, antisemitizmin apo forma të tjera të urrejtjes të bazuara në jo-tolerancë, përfshirë: jo-tolerancën e shprehur përmes nacionalizmit agresiv dhe etno-centrizmit, diskriminimit dhe armiqësisë kudër minoriteteve, emigranteve dhe njerëzve me origjinë imigranti." **Burimi:** Komiteti i Ministrave, Rekomandimi Nr. R (97) 20 (faqe 107), i qasur në Korrik 2016 tek www.coe.int/t/dghl/standardsetting/hrpolicy/other_committees/dh-lgbt_docs/CM_Rec(97)20_en.pdf
"Gjuhë që nuk përmban kuptim tjetër përpos shprehjes së urrejtjes për ndonjë grup, sikur një racë e caktuar, posaçërisht në rrethana ku ky komunikim ka gjasa të provokojë dhunë." **Burimi**: Fjalori i Drejtësisë i Black-ut (2009) edicioni i 9-të (faqe 1,529)
"Gjuha urrejtëse është një term që i referohet tërë spektrit të diskursit negativ, duke u nisur nga urrejtja apo paragjykimi dhe deri tek nxitja e urrejtjes. Gjuha urrejtëse është e dizajnuar të degradojë, frikësojë, apo nxis dhunë apo veprime paragjykuese kundër një personi apo grupi njerëzish bazuar në racën, gjininë, moshën, etninë, kombësinë, fenë, orientimin seksual, identitetin gjinorë, invaliditetin, aftësitë gjuhësore, pikëpamjet morale apo politike, klasën socio-ekonomike, punësimin apo dukjen (si gjatësinë, peshën, dhe ngjyrën e flokëve), kapacitetin mental dhe çfarëdo dallimit-pengese tjetër të tyre. Edhe pse "gjuha", përfshinë jo vetëm komunikimin oral apo të shkruar por gjithashtu edhe forma tjera të shprehjeve si për shembull filmat, artet, gjestet (gjuha simbolike)." **Burimi**: Asociacioni Evropian për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Gjuha Urrejtëse, i qasur në Korrik 2016 tek www.aedh.eu/plugins/fckeditor/userfiles/file/Discriminations% 20et%20droits%20des%20minorités/Hate%20speech.pdf
"Çfarëdo avokimi i urrejtjes nacionale, racore apo fetare që paraqet nxitje për diskriminim, armiqësi apo dhunë do të ndalohet me ligj." **Burimi**: Kombet e Bashkuara, Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, Neni 20 (2), i qasur në Korrik 2016 tek www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/ccpr.aspx
"Një person është fajtor për shkelje penale nëse ai- (a) Përdor kundër një personi tjetër fjalë apo sjellje kërcënuese, fyese apo ofenduese, apo (b) Shpërndan apo i paraqet një personi tjetër çfarëdo shkrimi, shenje apo paraqitje tjera të dukshme të cilat janë kërcënuese, fyese apo ofenduese, me qëllim që të shkaktojë tek ai person të besojë se dhunë e menjëhershme dhe e paligjshme do të ushtrohet mbi të apo ndonjë person tjetër nga çfarëdo personi, apo provokon përdorimin e menjëhershëm të dhunës së paligjshme nga ai person apo ndonjë tjetër, apo kur ai person ka gjasa të besojë se dhunë e tillë do të përdoret apo është e mundur që dhunë e tillë të provokohet." **Burimi**: Mbretëria e Bashkuar, Akti i Rendit Publik 1986 1986, s.4 (1), i qasur në Korrik 2016 tek http://www.harassmentlaw.co.uk/law/crimes.htm

Shtojca III: Shkalla e notimit e përdorur për deklaratat e skenarëve fiktiv

Rrethoni në tabelë një numër, nga 1 deri 5, për secilën deklaratë që ju përgjigjet juve, ku 1 do të thotë 'Unë fare nuk ndihem kështu', 3 do të thotë 'Jam neutral', dhe 5 do të thotë 'Unë ndihem plotësisht kështu'.

I/e zemëruar ndaj personit që e bën deklaratën	1	2	3	4	5
I/e zemruar ndaj personit/grupit kundër së cilit është duke u bërë deklarata	1	2	3	4	5
Demokracia zhvillohet duke përdorur këso gjuhe	1	2	3	4	5
Jam dashamirës (simpatizoj) personin që bën deklaratën	1	2	3	4	5
Jam dashamirës (simpatizoj) personin/grupin në shënjestër të deklaratës	1	2	3	4	5
Diskutime të tilla nxisin veprime të dhunshme	1	2	3	4	5
Unë ndiej parehati duke lexuar këtë skenar	1	2	3	4	5

Rretho një numër në tabelën më poshtë nga 1 deri 5, ku 1 do të thotë 'Aspak nuk ka gjasa (shansa) të ndërmarr aktivitete/sjellje të tilla', 3 do të thotë 'Neutral' dhe 5 do të thotë 'Ka gjasa (shansa) të mëdha që ju të ndërmerrni aktivitete/sjellje të tilla.'

Ta kritikoj verbalisht personin në shënjestër të pikëpamjes së raportuar	1	2	3	4	5
Ta kritikoj verbalisht personin të cilit po i raportohet pikëpamja	1	2	3	4	5
Të reagoj dhunshëm ndaj personit në shënjestër të deklaratës	1	2	3	4	5
Të reagoj dhunshëm ndaj personit të cilit po i raportohet pikëpamja	1	2	3	4	5
Të protestoj qetë kundër personit/grupit në shënjestër të deklaratës	1	2	3	4	5
Të protestoj qetë kundër personit të cilit po i raportohet pikëpamja	1	2	3	4	5
Të votoj në zgjedhje për personin/grupin në shënjestër të deklaratës	1	2	3	4	5
Të votoj në zgjedhje për personin të cilit po i raportohet pikëpamja	1	2	3	4	5